



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr** \_\_\_\_\_

**Dt: 30.06.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58. b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 14.a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe rekomandimit të Komisionit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dt: 25.06.2015, me të cilin është përkrahur kërkesa e Klubit Futbollistik “Rilindja e Kosovës” nga fshati Skivjan, Komuna e Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve të garave në Kampionatin e Kosovës në futboll, me dt: 30.06.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**1.** Miratohet kërkesa e Klubit Futbollistik “Rilindja e Kosovës ” nga fshati Skivjan nr. 10-400-41885 e dt: 25.06.2015, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij Klubi, duke e mbështetur me subvencione komunale të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 3,000.00€.

**2.** Në harmoni me kërkesën e Klubit Futbollistik “Rilindja e Kosovës ” nga fshati Skivjan nr.10-400-41885 dhe përgjigjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të dt: 26.06.2015, mjetet financiare në vlerë prej 3,000.00€ i barten në NPT “Armend Tours “, e cila i ka kryer shërbimin e transportit të lojtarëve për zhvillimin e garave në qytete të ndryshme të Kosovës.

**3.** Autorizohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,000.00 €, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e NPT “Armend Tours” nr.1140139393000123 .

**4.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**CO:** - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

-Z. Fadil Selimaj, përfaqësues i KF “Rilindja e Kosovës,” fsh.Skivjan

- Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**

\_\_\_\_\_  
**Znj. Mimoza Kusari- Lila**